



HYRËSE - ULAZNA - INCOMING



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA - VLADE - GOVERNMENT

KOMUNA HANI ELEZIT - OPSTINA HANI ELEZIT - MUNICIPALITY HANI I ELEZIT

Nr. 01, Mbi Për. 350, Datë 25.02.2016

HANI I ELEZIT



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



## STRATEGJIA KOMUNALE

Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare

2016-2018

Hani i Elezit 2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2016 miratoj:

**STRATEGJIA KOMUNALE PËR INFORMIM, KOMUNIKIM DHE PJESMARRJE  
QYTETARE 2016-2018**

**Fjala e kryetarit**

Strategjia e Informimit dhe Komunikimit (SIK), është një dokument shumë i rëndësishëm, i cili do t'u mundësoj institucioneve të komunës që jo vetëm të informojnë palët e interesit lidhur me rolin dhe ngritjen e profilit të tyre, por gjithashtu do të ndihmojë në arritjen e objektivave dhe politikave të veta. Në këtë mënyrë, do të krijojë një komunikim sa më efektiv, të përgjegjshëm me palët, por edhe të zhvillojë një strategji për të punuar me secilën palë të interesit.

Komuna e Hanit të Elezit, deri më tani është munduar që të mbajmë të informuar qytetarët, por edhe të komunikojmë me ta në forma të ndryshme përmes takimeve të organizuara nga këshillat e fshatrave, debateve publike por edhe takimeve të drejtpërdrejta. Me qëllim që të jemi sa më pranë qytetarit, por edhe mekanizmave të tjerë, siç janë edhe organizatat dhe shoqatat joqeveritare e grupe të tjera, kemi shfrytëzuar edhe komunikimin medial përmes shtypit të shkruar dhe elektronik por edhe intervistat e debatet e ndryshme, si edhe Web-faqen zyrtare dhe rrjetet sociale.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si kryetar i komunës rregullisht kam mbajtur dy debate me qytetarë për të arriturat dhe sfidat institucionale përmes së cilave qytetarët janë informuar drejtpërdrejt për atë se çfarë u intereson.

Po ashtu, gjatë vitit kam raportuar rregullisht gjatë qdo tre mujori para Kuvendit Komunal për punën e Ekzekutivit Komunal. Mirëpo, kemi mbajtur edhe debate, takime e diskutime qoftë të parapara me legjislacionin në fuqi qoftë edhe me rastin e hartimit të buxhetit komunal. Edhe komunikimi i brendshëm ka funksionuar, duke qenë vazhdimisht në kooordinim edhe me zyrën për informim.

Instalimi i rrjetit të telefonisë mobile midis punëtorëve të administratës, shëndetësisë, arsimit, këshillave lokale, komunitetin e biznesit ka dhënë rezultate të mira në rritjen e komunikimit më të mirë të brendshëm.

Është me rëndësi që Komuna e Hanit të Elezit të ketë Strategjinë e Informimit dhe Komunikimit, në bazë të së cilës do të fuqizohet më shumë mënyra e të komunikuarit e cila parasheh edhe format më të mira, duke rritur kështu edhe përgjegjshmërinë dhe nivelin e vetëdijes, sepse duhet të komunikohet me secilën palë të interesit, për të treguar çka dëshirojmë të arrijnë nga kjo marrëdhënie dhe si do të arrihet kjo.

Në procesin e zbatimit të Strategjisë së Informimit dhe Komunikimit duhet të jetë identifikimi i qartë për qytetarët dhe palët tjera të përfshira në procesin e komunikimit se si, kur dhe pse do të komunikohet.

Falënderoj OSBE-në, për mbështetjen që ka dhënë në hartimin e kësaj strategjie. Uroj që ky dokument të jetë i zbatueshëm dhe të jetë në shërbim të bashkëpunimit të mirë dhe komunikimit të drejtë, me qëllim që të ketë përparime edhe më të mëdha në fushën e komunikimit dhe informimit.

## PËRMBAJTJA:

1. Hyrje.....	04
2. Përmbledhje.....	05
3. Qëllimet.....	06
4. Parimet.....	06
5. Vizioni.....	07
6. Sektori i informimit dhe komunikimit në komunë.....	08
7. Struktura organizative e ekzekutivit të Komunës së Hanit të Elezit.....	09
8. Mjedisi legjislativ.....	10
9. Metodologjia e hartimit të dokumenteve strategjike.....	11
10. Informimi .....	12
11. Komunikimi efektiv.....	12
12. Komunikimet.....	13
13. Komunikimi efektiv me qytetarët dhe grupet e interes.....	14
14. Format e përfshirjes së OSHC-ve në procesin e rritjes së pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje dhe aktivitetet e qeverisjes lokale.....	14
15. Objektivat e Strategjisë.....	15
16. Plani i veprimit – Strategjia e Komunës së Hani i Elezit për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje qytetare.....	16
17. Buxheti.....	16
18. Struktura për zbatim.....	17
19. Përgjegjësitë .....	17



## 1. Hyrje

Strategjia e komunikimit është një përpjekje e re e Komunës së Hanit të Elezit për të përmirësuar cilësinë e punës për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve si një institucion transparente, efektive dhe të përgjegjshme. Kjo do të ndikonte në fuqizimin e lidhjes mes qytetarëve dhe Komunës së Hanit të Elezit dhe rrjedhimisht do të ndikonte në ngritjen e besimit tek institucionet.

Komuna e Hanit të Elezit duke dashur që të vërë në jetë sa më parë parimet dhe zotimet e paraqitura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, angazhohet që të ushtrojë të gjitha funksionet, mundësitë dhe të drejtat të garantuara me Kushtetutë, LVL-në dhe ligjet tjera të aplikuara në Republikën e Kosovës, për të përmirësuar komunikimin në mes komunës dhe qytetarit, për ta informuar në kohë dhe pa-anshëm opinionin publik mbi zhvillimet në komunën e Hanit të Elezit dhe për ta inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në aktivitetet komunale, me qëllim, ndërtimin e urave lidhëse në mes të qytetarit dhe pushtetit lokal, si dhe për ta forcuar besimin reciprok.

Në mënyrë që të arrihen këto synime madhore, komuna e Hanit të Elezit ka vendosur që t'i jetësoj këto përpjekje duke iu qasur në mënyrë strategjike. Pikërisht rregullimi i këtyre sfidave të qeverisjes lokale me strategji dhe plan veprimi, dëshmon përkushtimin e sinqertë dhe afatgjatë të komunës së Hanit të Elezit, për ofrim të shërbimeve kualitative, ndërtimin e urave lidhëse në mes të qytetarit dhe pushtetit lokal, si dhe për ta forcuar besimin e ndërsjellë.

## 2. Përmbledhje

Nevoja për themelimin e autoriteteve të pushtetit lokal lind nga nevoja e ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga niveli sa më i afërt i pushtetit. Pushteti lokal është adresa e parë të cilit qytetarët ia paraqesin shqetësimet dhe problemet e tyre të përditshme. Natyrshëm, pushteti lokal është adresa e parë nga e cila qytetarët presin zgjidhje për shqetësimet dhe problemet e tyre.

Informimi, komunikimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitetet e pushtetit lokal janë me rëndësi jetike për të vendosur një bashkëpunim dhe komunikim të rregullt në mes të komunës dhe qytetarëve. Mungesa e një marrëdhënieje të tillë ku qytetarët informohen mbi punët e komunës, ku komuna rregullisht komunikon me qytetarët dhe ku qytetarët marrin pjesë në aktivitetet e komunës do të paraqesë vështirësi të patejkalueshme në funksionimin normal të pushtetit lokal.

Një gjë e tillë vlen aq më shumë në një sistem juridik, sikurse që është sistemi juridik i Republikës së Kosovës, ku informimi i qytetarëve, komunikimi me qytetarë dhe pjesëmarrja e tyre në proceset vendimmarrëse në komunë është obligim ligjor.

Zhvillimet e hovshme teknologjike ofrojnë mundësi të shumta për informimin, komunikimin dhe përfshirjen e qytetarëve në aktivitetet e pushtetit lokal. Lehtësia në zbatimin e formave të reja të informimit dhe komunikimit me vete ka sjellë edhe rënie të kostos financiare të nevojshme për realizimin e informimit dhe komunikimit me qytetarë. Andaj futja në përdorim e formave moderne të komunikimit nga ana e komunës së Hanit të Elezit do të kontribuojë në avancimin e informimit dhe të komunikimit të ndërsjellë me qytetarin.

Në praktikë hasim shumë sfida në zbatimin jo vetëm të formave moderne por edhe të atyre konvencionale të informimit dhe komunikimit. Limitet e përcaktuara nga niveli qendror mbi numrin e shërbyesve civil që duhet t'i ketë një komunë, janë një barrierë mjaft e madhe, për të rritur kapacitetet e komunës në këtë drejtim.

Pengesë tjetër madhe paraqesin edhe kufizimet financiare të vendosura përsëri nga institucionet e nivelit qendror. Komunat janë të detyruar që mjetet financiare në dispozicion t'i adresojnë në fusha të cilat janë më prioritare duke mos qenë në gjendje të ndajnë mjete të nevojshme financiare për punë të komunikimit dhe informimit. Mungesa e resurseve humane dhe financiare padyshim që me vete sjell edhe kufizime teknike të cilat janë të domosdoshme për një model të avancuar të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet e komunës.

Problematike në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të komunës në kuptim të informimit dhe komunikimit me qytetarë paraqitet edhe mungesa e interesimit të vetë qytetarëve për të pranuar informata mbi punën e komunës, për të komunikuar me udhëheqësit e komunës apo edhe për të marrë pjesë në aktivitetet e komunës.



### 3. Qëllimet:

Realizimi i SIK-ut në baza afatgjata, ka për qëllim vendosjen e një sistemi të thjesht, unik, funksional dhe të zbatueshëm të komunikimit, i cili do të mundësojë realizimin e qëllimeve të vëna si:

- Transparenca dhe përgjegjësia publike e komunës, përmes komunikimit efikas me palët/qytetarët dhe përmes informimit mbi procedurat dhe të drejtat e tyre për qasje në dokumente publike;
- Nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje dhe në aktivitetet komunale, me qëllim të rritjes dhe bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjelltë;
- Ngritjen e cilësisë së kapaciteteve të komunikimit me grupe të interesit e sidomos me qytetarët, afaristët, investitorët dhe nivelet e larta të shtetit;
- Ngritjen e cilësisë së komunikimit me mediat;
- Transparencën financiare dhe racionalizimin e komunikimit brenda dhe jashtë komunës;
- Vendosjen e një sistemi efikas të komunikimit të brendshëm;
- Ngritjen e pasqyrës së përgjithshëm të komunës së Hanit të Elezit;

### 4. Parimet

Pritjet e qytetarëve në vazhdimësi janë të fokusuara në veprimtari transparente, llogaridhënëse, përgjegjëse, gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese të autoriteteve të pushtetit lokal. Këto në të njëjtën kohë paraqesin parimet bazë të punës së autoriteteve të pushtetit lokal dhe të komunikimit të tyre me qytetarë.

**4.1 Transparenca** – është parim bazë i komunikimit të komunës me qytetarët. Parimi i transparencës bazohet në informimin e qytetarëve me aktivitetet e komunës. Me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë kontekst është transparenca e ushtruar me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

**4.2 Llogaridhënia** – është parim i patejkalueshëm i komunikimit të komunës me qytetarët. Kryetari i komunës është i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarëve që jetojnë në komunë, andaj kryetari i komunës dhe të emëruarit e tij duhet të mbështeten në parimin e llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës. Rëndësi të madhe ka posaqërisht llogaridhënia financiare e komunës përballë qytetarëve.

**4.3 Përgjegjshmëria** – është parim i cili ndikon në rritjen e kualitetit të komunikimit të komunës me qytetarët. Komunikimi i rregullt i autoriteteve të pushtetit lokal me qytetarët siguron shkallë të lartë të përgjegjshmërisë së udhëheqësve përballë premtimeve, sukseseve dhe dështimeve eventuale të komunës. Përgjegjshmëria është akt i lartë moral i udhëheqësve të komunës treguar përballë qytetarëve të komunës si në rastet e sukseseve të komunës ashtu edhe në mossukseset e saj.

**4.4 Gjithëpërfshirja** – është parim i cili siguron bartjen e mesazhit të autoriteteve të pushtetit lokal tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit. Përmes zbatimit të parimit të gjithëpërfshirjes në komunikim, komuna siguron informimin e drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit.

**4.5 Mosdiskriminimi** – është parim i cili siguron shkallë të lartë të respektimit të të drejtave të njeriut. Zbatimi i parimit të mosdiskriminimit në komunikim nënkupton informim të drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Parimi i mosdiskriminimit në të njëjtën kohë nënkupton edhe marrjen parasysh dhe adresimin nga ana e komunës së kërkesave të të gjithë pa asnjë dallim.

**4.6 Shumëllojshmëria** – e kanaleve të shfrytëzuara për informim ofron një siguri më të madhe se informata e plasuar është pranuar nga grupet e synuara. Përmes këtij parimi nënkuptohet shfrytëzimi i sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale,

**4.7 Informimi me kohë** – është një nga parimet bazë të informimit. Një informatë e cila publikohet me vonesë nuk ka asnjë vlerë për opinionin. Me këtë nënkuptohet që komunat duhet të jenë mjaft aktive në informimin me kohë të qytetarëve në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e marrë.

**4.8 Informata kthyesë** – është parim i formave të avancuara të informimit dhe komunikimit. Përmes zbatimit të saj nënkuptohet ofrimi i mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo në vazhdim i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të performancës së saj.

## **5. Vizioni**

Qytetarë të informuar, me mekanizma efikase të komunikimit dhe të pjesëmarrjes, duke e bërë kështu Komunën e Hanit të Elezit të përgjegjshme, transparente ndaj qytetarëve të saj.

Komuna e Hanit të Elezit ka për qëllim përmirësimin e mekanizmit për informim dhe komunikim, më synim që tu përgjigjet nevojave të qytetarëve.

Përmes kësaj strategjie qytetarët e komunës do të jenë informuar për zhvillimet komunale, për proceset e vendim marrjes më qëllim të rritjes së nivelit të transparencës para qytetarëve dhe institucioneve të tjera relevante. Më këtë vizion komuna synon që në periudhën trevjeçare të krijojë strukturë për informim dhe komunikim efektiv me qytetarët dhe pushtetin lokal. Vizioni është ndërtuar mbi këto parime:

- Qytetar të informuar mirë
- Komunikim efektiv
- Interesat e qytetarëve të përfaqësuara
- Mjedis i përshtatshëm komunal për pjesëmarrje të qytetarëve



## 6. Sektori i informimit dhe komunikimit në komunë

Zyra për Informim Publik që nga themelimi i saj ka për mandat të ndërtojë marrëdhënie të mira me publikun dhe ta informojë atë me kohë. Zyra siguron informim të vazhdueshëm për të gjithë qytetarët e komunës dhe më gjerë. Kjo zyrë vepron në kuadër të Drejtorisë së Administratës.

Udhëhiqet nga zyrtari për informim publik dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- I ofron qytetarëve të komunës informatat e rregullta përmes medieve.
- Organizon kontakte të rregullta me mediet, konferenca për shtyp në baza periodike, lëshon njoftime dhe komunikata për shtyp.
- Bashkërendon kontakte në mes të zyrtarëve komunalë dhe medieve
- Përpilon dhe mirëmban faqen zyrtare të internetit të komunës në dy gjuhë zyrtare (dmth përfshin informata mbi aktivitetet komunale, raportet, kalendarin e takimeve, regjistrin e numrave të telefonit dhe informatat kontaktuese të zyrtarëve komunalë)
- Bashkërendon veprimet me drejtoritë komunale në harmoni me dokumentet komunale dhe i promovon ato (psh me broshura dhe afishe për qytetarë rreth shërbimeve ngjarjeve komunale).
- Siguron informatat nga shtypi (lajmërimet për mbajtjen e takimeve, informatat mbi vendimet që janë marrë etj) nga të gjitha ngjarjet komunale, siç janë psh takimet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të saj.
- I jep mbështetje aktive kryetarit të komunës, drejtorive komunale, kuvendit komunal dhe komiteteve të tij në koordinimin, organizimin, zbatimin dhe prezantimin në terren të aktiviteteve komunale.

Zyra për Informim Publik bashkëpunon dhe mbanë kontakte me zyrtarët komunalë dhe informon palët e interesit. Gjithashtu mbështet fushatat mediale për çështjet përkatëse komunale. Arkivon fotografi, raporte, komunikata për shtyp, etj. Organizon dhe bashkërendon konsultimet publike. Mbështet në kontinutete dëgjimet publike para miratimit të akteve komunale.

Zyra për informim publik, pasqyron vazhdimisht aktivitetet e zhvilluara në gjithë hapësirën komunale. Të gjitha aktivitet që zhvillohen në komunë njoftohen përmes: Tabelës së njoftimeve, Web Faqes zyrtare, mediave sociale media elektronike dhe të shkruara

Përcjellja e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen brenda dhe jashtë komunës është përgjegjësi me peshë për punën e zyrtarit për informim publik. Për zbatimin e kësaj strategjie për informim dhe komunikim, zyra duhet të angazhohet për të arritur këto objektiva:

- Komuna të jetë më afër qytetarit.
- Lidhja e qytetarit me shërbimet komunale.
- Qytetarët pjesë e sistemit vendim marrës .
- Komunikim i përhershëm më qytetarin .
- Botimi i fletëpalosjes, broshurës për aktivitet e komunës dhe anasjelltas.
- Botimi i përmbledhur i ngjarjeve dhe zhvillimeve në "Vjetarë" .



- Informacionet relevante për punën e komunës dhe të drejtat e qytetarëve do të përmbliken në një broshurë informative.
- Në kuadër të zyrës për informim publik vepron edhe Web faqja e komunës e krijuar që nga viti 2009 (<https://kk.rks-gov.net/hanielezit/>). Kjo Web faqe zyrtare u mundëson qasje më të lehtë qytetarëve në ngjarjet komunale, pasi postohen në mënyrë të vazhdueshme dokumentet dhe ngjarjet e rëndësishme që janë në interes për qytetarët e Komunës së Hani i Elezit.

Prej krijimit të Web faqes dhe standardizimit të saj, kjo Web faqe ka rritur interesimin e qytetareve për përcjelljen e aktiviteteve të pushtetit lokal.

Rol të rëndësishëm në informim dhe komunikimin më qytetarin dhe opinionin e gjerë luajnë edhe rrjetet sociale. Për të siguruar bartje të shpejtë dhe efektive të informacionit zyrtar, zyra për informim publik, përveç Web faqes (Web portalit), komuna e Hanit të Elezit ka aktive edhe Faqen zyrtare në rrjetin social Facebook. (<https://www.facebook.com/Komuna-Hani-i-Elezit-194058514137478/>) dhe Twiter (<https://twitter.com/komuna1>)

#### **7. Struktura organizative e ekzekutivit të Komunës së Hanit të Elezit**

Ekzekutivi e Komunës së Hanit të Elezit përbëhet nga 8 drejtori:

1. Drejtoria e administratës;
2. Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
3. Drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport;
4. Drejtoria për buxhet dhe financa;
5. Drejtoria për urbanizëm kadastër dhe mbrojtje të mjedisit ;
6. Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë civile;
7. Drejtoria për zhvillim ekonomik;
8. Drejtoria për bujqësi pylltari dhe zhvillim rural;

Në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Hani i Elezit veprojnë edhe këto zyre dhe njësi:

1. Zyra e prokurimit
2. Zyra e personelit;
3. Zyra ligjore
4. Zyra për barazi gjinore;
5. Zyra për integritet evropiane;
6. Zyra për kthim dhe komunitete

## 8. Mjedisi legjislativ

Korniza ligjore e vendit rregullon shumë çështje që ndërlidhen me informimin, komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitetet e komunës. Kushtetuta e vendit, sistemin e vetëqeverisjes lokale të Kosovës e bazon në parime të avancuara të pushtetit lokal.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - thekson se vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për vetëqeverisje lokale – rregullon transparencën në pushtetit lokal duke përfshirë informimin e qytetarëve mbi aktivitetet e organeve të komunës dhe segmente të caktuara të komunikimit me qytetarë. Në bazë të këtij Ligji komunat obligohen që:

- T'i njoftojnë qytetarët mbi mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të trupave të saj;
- T'i publikojnë vendimet e kuvendit të komunës;
- Të mbajne takime periodike me qytetarët;
- Të shqyrtojnë peticionet dhe iniciativat e qytetarëve;

Ligji për qasje në dokumente publike – rregullon procedurat me të cilat institucionet shtetërore, duke i përfshirë edhe komunat, duhet t'u lejojnë qytetarëve të drejtën e garantuar për qasje në dokumente publike. Ky Ligj parasheh dispozita ndëshkuese ndaj zyrtarëve të cilët veprojnë në kundërshtim me të dhe të cilët pengojnë realizimin e të drejtës së qytetarëve për qasje në dokumente publike.

Udhëzimi administrativ për transparencë në komuna – ofron një përshkrim detal të përgjegjësisve dhe obligimeve të komunave të cilat duhet të ndërmerren në raport me transparencën përballë qytetarëve. Sipas këtij akti nënligjor, komunat janë të obliguara:

- T'i publikojnë të gjitha aktet me interes të përgjithshëm të komunës;
- T'i konsultojnë qytetarët para miratimit të akteve me interes të përgjithshëm;
- Të hartojnë Plan të veprimit për transparencë;

Udhëzimi administrativ për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shërbimit të qytetarëve në komuna – përcakton veprimet që duhet t'i ndërmarrë komuna me qëllim të informimit të qytetarëve me kushtet, procedurat administrative dhe ligjore si dhe afatet kohore për trajtimin e kërkesave të qytetarëve për shërbimet të cilat ofrohen nga komuna. Sipas këtij akti nënligjor, të gjitha njoftimet përkatëse komuna duhet t'i bëjë edhe përmes ueb faqes elektronike të saj.

Statuti i Komunës së Hanit të Elezit me anë të të cilit përcaktohet parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.



Rregullorja për transparencë – me anë të të cilit përcaktohen obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Hanit të Elezit dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

#### **9. Metodologjia e hartimit të dokumenteve strategjike**

Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare në Komunën e Hanit të Elezit bazohet në kushtetuten e Republikën e Kosovës, Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për qasje në dokumente publike, Udhëzimin administrativ për transparencë në komuna, Udhëzimin administrativ për organizimin dhe funksionimin e qendrë së shërbimit të qytetarëve në komuna, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit dhe Rregulloren për transparencë.

Për hartimin strategjisë dhe të planit të veprimit për komunën e Hanit të Elezit është formuar një grup i punës, i përbërë nga përfaqësues të komunës, nga organizatat e shoqërisë civile. Përveç kësaj, janë konsultuar edhe përfaqësues të zyreve për informim të publikut nga komunat tjera si dhe organet komunale të komunave të tjera të Republikës së Kosovës për të marrë praktikën e mira ashtu që kjo strategji dhe ky plan i veprimit të jetë i përdorshëm, i zbatueshëm dhe funksional.

Tryezat dhe punëtoritë gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit për përfshirjen e një game të gjerë të aktorëve nga qeverisja lokale dhe komuniteti i organizatave jo-qeveritare. Kjo qasje ofron garanci që strategjia do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë.

Ky grup i punës ka analizuar rezultatet e të gjitha punëtorive paraprake duke i definuar në mënyrë eksplicite sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që lidhen me sfidat e informim në kohë dhe të pa-anshëm, komunikimit efektiv me publikun dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe aktivitetet tjera të komunës me interes të përgjithshëm në komunën e Hanit të Elezit, në fushat e trajtuara me strategji dhe plan veprimi.

Qëllimi i strategjisë dhe të planit të veprimit është që të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve të qëndrueshme institucionale të komunës së Hanit të Elezit, duke synuar vendosjen e një kulture institucionale të informimit të shpejt dhe të pa-anshëm, komunikimit efektiv, dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje dhe aktivitetet e pushtetit lokal.

Strategjia dhe plani i veprimit nuk synon të zëvendësojë por të plotësojë nismat e përgjithshme. Rrjedhimisht, strategjia dhe plani i veprimit ndjek një qasje kryesore sa herë që

Zbatimi i sinqertë dhe realist i strategjisë i bazuar në burimet e identifikuar financiare është kyç për përmirësimin e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes qytetare. Përfshirja e zbatimit të strategjisë si prioritet është garanci për zbatimin e sinqertë dhe realist.

Komuna e Hanit të Elezit do të themelojë një mekanizëm përgjegjës për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për informim, komunikim dhe pjesëmarrje qytetare.



## **10. Informimi**

Synim primar i komunës mbetet informimi i qytetarëve mbi punën e organeve të saj. Angazhimi i kryetarit të komunës, i kuvendit të komunës, i drejtorive dhe segmenteve tjera të komunës në vazhdimësi synohet që t'i prezantohet qytetarëve përmes informimit të shpejtë dhe të saktë. Publikimi me kohë i vendimeve të kryetarit të komunës, i vendimeve të kuvendit të komunës, i raporteve të punës së drejtorive të komunës me theks të veçantë i raporteve periodike financiare mbetet synim i përhershëm i komunës. Komuna e Hanit të Elezit përmes përbushjes së obligimeve ligjore për informim të qytetarëve por edhe realizimit të aktiviteteve tjera të cilat i tejkalojnë kërkesat e dala nga legjislacioni, synon që të paraqesë një pasqyrë të plotë dhe reale mbi punën dhe angazhimin e organeve komunale. Përmes një informimit të drejtë dhe me kohë të qytetarëve mbi punën e komunës hapen mundësitë për thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit të Komunës së Hanit të Elezit me qytetarët e saj. Kjo më tej mundëson vendosjen e komunikimit të rregullt të komunës dhe qytetarëve dhe lehtëson pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitetet e komunës.

Burim kryesor i informatës është ueb faqja e komunës dhe konferencat periodike për gazetarë. Ueb faqja ofron informata mbi aktivitetet e organeve të komunës përmes të cilave synohet përbushja e obligimeve që dalin nga legjislacioni në fuqi për informimin e qytetarëve. Në te ofrohen informata të shumta mbi strukturën organizative të komunës, shërbimet e ofruara, vendimet e marra nga kryetari dhe kuvendi i komunës. Dokumenti i buxhetit të komunës si dhe raportet periodike financiare të realizimit të buxhetit janë një tjetër burim i rëndësishëm prej nga qytetarët informohen mbi aktivitetet e komunës.

Komunikimi me Web-Faqen, rrjetet sociale dhe mediat janë metoda të cilën Komuna e Hanit të Elezit e shfrytëzon si mjet për bartjen e informatës tek qytetarët. Trendi në rritje i shfrytëzimit të rrjeteve sociale ofron një alternativë të shpejtë, të lirë dhe efikase të bartjes së informatës nga komuna tek qytetari dhe anasjelltas.

Synim i Komunës së Hanit të Elezit mbetet angazhimi i vazhdueshëm rreth krijimit të një Web faqeje shumëdimensionale dhe multifunksionale ku qytetarët mund të sigurojnë platformë përmes së cilës ofrohen shërbime të shpejta dhe kualitative për qytetarët e saj.

Komuna e Hanit të Elezit për çdo vit publikon "Vjetarin" me të cilën në mënyrë kronologjike pasqyrohen zhvillimet më të rëndësishme të vitit dhe dokumentet e rëndësishme në interes të publikut.

## **11. Komunikimi efektiv**

Komuna e Hanit të Elezit ka një përvojë të mirë në kuptim të komunikimit me qytetarë posaçërisht në procesin e hartimit të buxhetit të komunës. Në kuadër të saj organizohen një numër i takimeve me qytetarë ku përmes komunikimit të drejtpërdrejtë paraqiten propozimet e komunës për buxhet dhe merren sugjerimet dhe kërkesat e qytetarëve për t'u shqyrtuar më tej nga organet kompetente. Kjo përvojë përcillet me parimin e gjithëpërfshirjes dhe përgjegjshmërisë. Në të gjitha zonat e komunës mbahen takime ku debatohet rreth buxhetit të komunës. Formë tjetër e komunikimit të komunës me qytetarët është edhe ajo e organizimit të takimeve të drejtpërdrejta me qytetarë ku kryetari dhe zyrtarë tjerë të komunës ua



komunikojnë qytetarëve aktivitetin e tyre dhe ua prezantojnë sukseset e sektorëve tyre përkatës. Këto takime janë një mundësi e mirë edhe për qytetarët të cilët kanë mundësinë e komunikimit të kërkesave, shqetësimeve apo rekomandimeve të tyre tek zyrtarët e komunës. Takime të posaçme të karakterit të tillë mbahen në kohë të përshtatshme edhe me qytetarët të cilët jetojnë në diasporë.

Synim primar mbetet përfshirja e sa më shumë qytetarëve nga të gjitha zonat, komunitetet dhe grupeve tjera të interesit në procesin e hartimit të buxhetit. Vetëm përmes një procesi të tillë do të arrihet deri te një buxhet gjithëpërfshirës që i përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve të komunës. Organizimi i takimeve të drejtpërdrejta të kryetarit të komunës me grupe të ndryshme të interesit (biznese, OJQ-të, media, komunitete, etj.) me qëllim të thellimit të komunikimit të ndërsjellë paraqet synimin tjetër strategjik të komunës.

## **12. Komunikimet**

### **12.1 Komunikimi i brendshëm**

Analiza e komunikimit të brendshëm varet nga mbledhjet e stafit, telefoni, interneti, e-maili, tabelat e shpalljeve, korrespondenca e brendshme etj. Të gjithë nëpunësit bashkëpunojnë me Zyrën për Informim dhe i japin asaj informacione që janë të nevojshme për t'u publikuar.

Komunikimi i brendshëm në kuadër të qeverisjes lokale zhvillohet pos tjerash edhe përmes organizimit të mbledhjeve të niveleve të ndryshme, të cilat të punësuarve u mundësojnë informim dhe sistemim më të mirë të punës.

Në nivel të qeverisjes komunale janë paraparë mbledhjet e bordit të drejtorëve komunalë që mbahen çdo të hënë në orën 08:15. Përveç kryetarit, nënkryetarit, drejtorëve të komunës në këto takime marrin pjesë Zyrtari i Prokurimit, Udhëheqësja e personeli, zyrtari ligjorë dhe zyrtari për informim.

### **12.2 Komunikimi i jashtëm**

Komunikimi i jashtëm nënkupton korrespondencën reciproke cilësore të organeve lokale dhe segmenteve të jashtme, prej të cilave varet edhe reputacioni i tyre. Mediave, OJQ-ve dhe palëve të interesuara iu dërgohen me kohë ftesat për aktivitetet që do t'i ndërmer komuna, apo materialet e nevojshme siç janë fotografitë, vendimet etj.

### **12.3. Marrëdhëniet me publikun**

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) informon qytetarët, mediat e shkruara si dhe ato elektronike për aktivitetin e komunës. Ajo, trajton kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet publike në çfarëdo forme të garantuara me ligjet në fuqi.

Roli i mediave në krijimin e vetëdijes shoqërore por edhe i pasqyrës apo fotografisë mbi organet lokale është i pamatshëm.

Marrëdhëniet me media duhet të ndërtohen në mënyrë sistematike dhe proaktive. Marrëdhëniet me mediat realizohen nga Zyra për Informim Publik.

### **12.4 Debatet publike dhe takimet me qytetarë dhe grupet e interesit**

Me statutin e Komunës së Hanit të Elezit, janë rregulluar mënyra dhe procedura e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupet e interesit në çështjet publike.

Qytetarët mund të marrin pjesë në takime, debate publike, referendum, peticione apo të bëjnë ankesa. Takimet apo debatet publike dhe dëgjimet publike do të organizohen në përputhje me obligimet ligjore dhe planifikimeve të ekzekutivit dhe legjislativit për tu konsultuar me publikun.

#### **12.5 Këshillat e fshatrave**

Komuna e Hanit të Elezit ka formuar dhe janë funksionale këshillat e fshatrave, përmes të cilave realizohen aktivitetet për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje për çështjet në interes publik për banorët lokalë dhe për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Qeverisja lokale përmes organeve kompetente-Zyrës për koordinimin e këshillave të fshatrave, bashkërendon veprimet dhe bashkëpunimin me to.

Komunikimi me këshillat e fshatrave bëhet përmes kontakteve të drejtpërdrejta, apo përmes shkresave dhe telefonit. Komuna ua heq harxhimet e telefonit kryetarëve të këshillave të fshatrave. Ata poashtu ftohen në të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet me rëndësi që i organizon komuna.

Kryetarët e këshillave të fshatrave informojnë me shkrim zyrtarin për bashkëpunim dhe bashkërendim për problemet që dalin në vendbanimet e tyre i cili raporton për punën e tyre para kuvendit..

#### **13. Komunikimi efektiv me qytetarët dhe grupet e interesit**

Objektiva e komunikimit efektiv synon krijimin e mënyrave sa më efektive të komunikimit me të gjitha palët e interesit, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe bizneset. Ky objektivë synon të ndërtojë mekanizmat për komunikim të efektshëm me qytetarët, të sigurojë informacionin kthyes nga qytetarët lidhur me hartimin e buxhetit, vendimet e komunës me rëndësi për qytetarët, dhe të sigurojë marrjen e opinionit publik para marrjes së vendimeve të ndryshme që ndikojnë në jetën e tyre. Gjithashtu objektiva synon përmirësimin e komunikimit me institucionet publike dhe shërbyese rajonale dhe të tjera, ashtu që qytetari jo vetëm të informohet por edhe të ketë të drejtën e komunikimit për shërbimet që ndikojnë në mirëqenien e tyre. Kapacitete të ngritura të komunës për komunikim efektiv është një fushë tjetër që planifikohet, ku pritet që personeli i komunës të fuqizojë kapacitetet gjatë ndërveprimit me qytetarët. Për të rritur kapacitetet e komunës në komunikim, është planifikuar të merren edhe praktikata e mira nga vendet e rajonit, ashtu që të rritet performanca e komunikimit edhe në komunën e Hani të Elezit.

#### **14. Format e përfshirjes së OSHC-ve në procesin e rritjes së pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje dhe aktivitetet e qeverisjes lokale**

Organizatat e shoqërisë civile të organizuara mirë dhe të përfshira në të gjitha proceset vendimarrëse në nivel lokal, si dhe të përfshira në aktivitetet e pushtetit lokal mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në nxjerrjen e vendimeve lokale më të mira, në shpërndarjen efikase dhe proporcionale të buxhetit komunal, në mënyrën e shpenzimit të parasë publike, në



zbatimin më të përgjegjshëm të rregulloreve dhe vendimeve të kuvendit dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit në përgjithësi.

Ky dokument strategjik do të mund tu shërbej organizatave të shoqërisë civile, të cilat zhvillojnë ose zbatojnë projekte në fushën e përmirësimit të qeverisjes lokale, monitorimit të punës së saj, transparencës dhe të logaridhënjes, si dhe edukimit qytetar për rritje të pjesëmarrjes qytetare dhe të rritjes së angazhimit efektiv të tyre dhe grupeve të interesit në vendimmarrjen lokale në përgjithësi, në vendime për prioritizimin e nevojave dhe projekte konkrete për qytetarin në veçanti.

## **15. Objektivat e Strategjisë**

Informim cilësor i qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit

Me këtë objektivë është menduar të përmirësohet cilësia e informimit si përbrenda sektorëve të komunës ashtu edhe me qytetarë, biznese dhe organizata të shoqërisë civile, gjegjësisht synohet informimi i drejtë, i paanshëm dhe me kohë për të gjithë.

Ky objektivë nënkupton që fillimisht të ngriten dhe fuqizohen kapacitetet e të gjithë personelit të komunës përgjegjës për informim. Kjo është menduar të arrihet përmes trajnimeve të ndryshme dhe duke përdorur teknologjinë dhe mënyrat më bashkëkohore të informimit. Gjithashtu ky objektivë synon që të krijohet mekanizmi i qëndrueshëm për marrjen e informacionit si përbrenda sektorëve të komunës, ashtu edhe nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset. Përbushja e këtij objektivë përmirëson dhe sistemin e informimit të sektorëve brenda komunës gjithnjë në shërbim të rritjes së performancës të drejtorive dhe zyrave të ndryshme. Objektiva, ndër tjerash, synon të përmbushë të drejtën themelore të njeriut për informim të drejtë dhe me kohë, ashtu që shërbimet të jenë sa më cilësore për të gjithë qytetarët e komunës së Hanit të Elezit

Gjithashtu, diaspora ka të drejtën që të informohet me kohë për të gjitha zhvillimet që ndodhin në komunën nga vijnë, sidomos kur ka të bëjë me shërbimet me interes të tyre.

Realizimi i kësaj objektivë pritet të ndikojë në informimin e qytetarëve për veprimtarinë dhe vizionin e komunës gjithnjë duke marrë parasysh interesin e qytetarit përmes krijimit të mekanizmave ndërlidhëse me qytetarin. Dokumenti përveç që rregullon përçimin e informacionit për aktivitetet e qeverisë lokale ajo në të njëjtën kohe përmes mekanizmave të parapara ofron mundësinë që qytetarët të shfrytëzojnë shërbimet që ofron komuna, dhe mundëson që përfaqësuesit e qeverisë lokale të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin. Gjithashtu kjo objektivë synon që informimi i qytetarit të mos jetë në funksion të promovimit të punës së komunës por të jetë si pjesë përbërëse e qeverisjes. Disa nga veglat e propozuara janë: 1) Mjetet e Informimit si a) Web faqja e komunës dhe b) bilbordet, broshurat, posterat, fletushkat etj; 2) Rrjetet sociale si a) twitter, b) facebook dhe c) youtube; 3) Mediat e shkruara; 4) Mediet elektronike si a) Rrjeti kablor; b) TV Qendrore; 3) Radiot.

## 16. Plani i veprimt – Strategjia e Komunës së Hani i Elezit për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje qytetare

Kjo objektivë nënkupton që fillimisht të ngriten dhe fuqizohen kapacitetet e të gjithë personelit të komunës përgjegjës për informim. Kjo është menduar të arrihet përmes trajnimeve të ndryshme dhe duke përdorur teknologjinë dhe mënyrat më bashkëkohore të informimit. Gjithashtu kjo objektivë synon që të krijohet mekanizmi i qëndrueshëm për marrjen e informacionit si përbrenda sektorëve të komunës, ashtu edhe nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset. Përbushja e kësaj objektivë përmirëson dhe sistemin e informimit të sektorëve brenda komunës gjithnjë në shërbim të rritjes së performancës të drejtorive dhe zyrave të ndryshme. Objektiva, ndër tjerash, synon të përbushë të drejtën themelore të njeriut për informim të drejtë dhe me kohë, ashtu që shërbimet të jenë sa më cilësore për të gjithë qytetarët e komunës së Hanit të Elezit.

Strategjia e Komunës së Hani i Elezit për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje qytetare do të zbërthehet në plane pune vjetore me objektivat e identifikuara.

## 17. Buxheti

Kostoja e përgjithshme e planit komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje, për periudhë tre vjeçare, është vlerësuar në 15.000.00 €. Periudha e zbatimit përfshin vitin 2016, vitin 2017, vitin 2018, kur dhe pritet të rishikohen rezultatet dhe të vazhdojë viteve në vijim.

Për vitin 2016 janë planifikuar 5.000 €, gjersa për vitin 2017 janë planifikuar 5.000 € dhe për vitin 2018 janë 5.000 €.

Meqenëse aktivitetet e planifikuara në këtë dokument strategjik synojnë të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin e biznesit, ekzistojnë mundësitë që një pjesë e kostonë së këtij dokumenti strategjik të reduktohet, ose të zgjerohet varësisht prej programeve dhe projekteve që i realizojnë organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset. Gjithashtu, nuk përjashtohen mundësitë e përkrahjes nga agjencionet zhvillimore / donatorët për të zbatuar masa të ndryshme të këtij dokumenti.

Nr	Objektiva	Kostoja vjetore		
		2016	2017	2018
O1	Informim cilësor i qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit	4000.00 €	4000.00€	4000.00€
O2	Komunikimi efektiv me qytetarët dhe grupet e interesit	500.00€	500.00€	500.00€
O3	Mjedis i përshtatshëm për pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe transparencë	500.00	500.00€	500.00


Gjithsej kostoja

15.000.00 €



## 18. Struktura për zbatim

Struktura organizative e mekanizmit koordinues, monitorues dhe implementues të 'Strategjisë dhe Planit Komunal të Veprimit për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare' në Komunën e Hanit të Elezit



## 20. Përgjegjësitë

**Koordinatori:** Koordinimi, bashkërendimi, monitorimi dhe raportimi mbi implementimin e strategjisë dhe të PV për informim, komunikim dhe pjesëmarrje qytetare, si dhe kryeson takimet me grupet punuese.

**Grupi Teknik i Punës për Planin e Veprimit:** Grumbullon materialet e GP, sistemon, analizon si dhe përcjellë vendimet eventuale të koordinatorit ndaj GP.

Përgatitë material të nevojshëm për Koordinatorin.

**Grupi punues (Gp):** Në këto GP janë përfaqësuesit e Komunës së Hanit të Elezit, mandatet e të cilëve janë të koordinojnë zbatimin e PV, të monitorojnë dhe raportojnë mbi të arriturat.

Hani i Elezit

Data: 25.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit  
Qamush Brava

